

VENDIM

Nr. 789, datë 22.9.2015

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, STANDARDEVE DHE PROCEDURAVE TË PROGRAMIT TË CERTIFIKIMIT PËR PROFESIONISTË TË SHËNDETËSISË

(Ndryshuar me VKM nr. 66, datë 13.2.2019)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 33, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Programi i certifikimit për profesionistët e shëndetësisë ka si qëllim të mbështetë, të fuqizojë dhe të promovojë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve të shëndetësisë, në mënyrë që ata të ofrojnë një kujdes shëndetësor sa më cilësor për pacientët.

2. Në këtë projektvendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Certifikimi", procesi që profesionisti i shëndetësisë përfundon me përbushjen e kriterëve të secilit cikël të programit të certifikimit dhe lidhet me ecjen në karrierë të profesionistit të shëndetësisë;

b) "Profesionistë shëndetësorë", personat e pajisur me dijet e nevojshme shkencore dhe profesionale që ushtrojnë profesionin e tyre në fusha dhe profile të ndryshme të sistemit shëndetësor.

II. KRITERET DHE STANDARDET E PROGRAMIT TË CERTIFIKIMIT

1. Profesionistët e përfshirë në programin e certifikimit

1.1 Profesionistët e përfshirë në programin e certifikimit janë: mjekët, stomatologët, farmacistët e ndihmësfarmacistët dhe infermierët e mamitë, shtetas shqiptarë dhe të huaj, që ofrojnë shërbime shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, në institucionet publike ose private të kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe terciar dhe ata të institucioneve akademike shëndetësore. Nuk përfshihen në program profesionistët që punojnë në administratë.

1.2 Ata profesionistë, të cilët mbushin moshën e daljes në pension brenda periudhës së programit të certifikimit dhe nuk kërkojnë rinovimin e lejes së ushtrimit të profesionit nga urdhri profesionist përkatës, përjashtohen nga detyrimet e programit të certifikimit.

1.3 Profesionistët, të cilët gjatë një viti kalendarik të ciklit të programit ndërpresin punën për një periudhë 4-mujore ose edhe më gjatë, përjashtohen nga kërkesat e programit për atë vit kalendarik.

1.4 Profesionistët të cilët janë në pension dhe ushtrojnë profesionin.

1.5 Profesionistët, të cilët punojnë me kohë të pjesshme, duhet të plotësojnë të njëjtat kriterë të programit si ata që ushtrojnë profesionin e tyre me kohë të plotë.

2. Kohëzgjatja e programit të certifikimit

Programi i certifikimit për profesionistët e shëndetësisë është i organizuar në cikle 4-vjeçare, brenda të cilave profesionistët e shëndetësisë duhet të përbushin kriteret siç përcaktohen në pikat 3 dhe 4 të këtij kreu.

3. Numri i krediteve të kërkuara

3.1 Brenda një cikli 4-vjeçar, mjekët duhet të mbledhin një numër jo më të vogël se 120 kredite të edukimit në vazhdim, stomatologët dhe farmacistët e ndihmësfarmacistët 60 kredite, ndërsa infermierët e mamitë 40 kredite. Numri i nevojshëm i krediteve të edukimit në vazhdim, që një profesionist i përfshirë në programin e certifikimit duhet të mbledhë sipas kategorive të aktiviteteve, është si më poshtë:

3.1.1 Kreditet e përfituara nga aktivitete të edukimit në vazhdim të lidhura drejtpërdrejt me specialitetin e profesionistit duhet të përbëjnë të paktën 50% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara nga profesionisti;

3.1.2 Kredite të përfituara nga aktivitete të edukimit në distancë duhet të përbëjnë jo më shumë se 50% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara.

3.2 Kredite të përfituara nga aktivitete të vetëraportuara të përlogariten deri në 20% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara nga profesionisti.

3.3 Numri vjetor minimal i detyrueshëm i krediteve të edukimit në vazhdim për mjekët është 10 kredite,

për farmacistët, ndihmësfarmacistët dhe stomatologët 5 kredite.

3.4 Pjesa tjetër e krediteve të nevojshme përcaktohet nga zgjedhja e lirë e profesionistit, në bazë të nevojave individuale.

3.5 Në fund të ciklit 4-vjeçar të certifikimit, përveç numrit të krediteve të kërkuara, profesionistët duhet të marrin 10 kredite përmes një testi vetëvlerësimi. Ky test kryhet *on-line* dhe lidhet me specialitetin e profesionistit. Ministria e Shëndetësisë harton rregulloren për zhvillimin e testit dhe është përgjegjëse për administrimin e tij.

3.6 Në përmbushje të kriterëve të mësipërme, profesionisti vlerësohet se ka kryer procesin e certifikimit dhe pajiset me vërtetimin përkatës.

4. Standardet e certifikimit

4.1 Profesionisti nxitet ta planifikojë vetë pjesëmarrjen në aktivitete të edukimit në vazhdim, bazuar në qëllimin e praktikës së tij profesionale, nevojat e identifikuar dhe kompetencat e dëshiruara.

4.2 Profesionisti zgjedh ato aktivitete që bazohen në nevojat e perceptuara nga ai vetë, si dhe në ato që janë identifikuar nga vlerësime të tjera.

4.3 Aktiviteti i edukimit në vazhdim duhet të ketë lidhje me specialitetin, rolin profesional dhe përgjegjësitë që ka profesionisti në pozicionin aktual të punës.

4.4 Profesionisti duhet të jetë i angazhuar për të ruajtur profesionalizmin gjatë gjithë kohës së ushtrimit të profesionit dhe në kujdesin që ofron, përmes përmirësimit të vazhdueshëm.

4.5 Profesionisti nxitet ta integrojë procesin individual të të mësuarit në atë të ekipit me të cilin punon, grupe të kolegëve apo komunitetin e gjerë.

4.6 Profesionistit duhet t'i krijohen mundësitë dhe kushtet e përshtatshme nga strukturat dhe institucionet shëndetësore për ndjekjen e aktiviteteve të edukimit në vazhdim.

III. PROCEDURA TË PROGRAMIT TË CERTIFIKIMIT

1. Regjistrimi i profesionistëve në programin e certifikimit

Të gjithë profesionistët e përfshirë në programin e certifikimit janë përgjegjës për regjistrimin e tyre në Regjistrin Kombëtar të Certifikimit të Profesionistëve që administrohet nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (QKEV), si dhe për vërtetësinë e të dhënave të dokumentuara në dosjen e tyre individuale.

2. Njohja dhe regjistrimi i krediteve

3. Aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht

3.1 Regjistrimi i krediteve nga aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht nga QKEV-ja. Në rastet kur profesionisti merr pjesë në një aktivitet të edukimit në vazhdim të akredituar paraprakisht nga QKEV-ja, atëherë raportimi i krediteve përkatëse është përgjegjësi e ofruesit të aktivitetit, i cili duhet të dorëzojë pranë QKEV-së listën e pjesëmarrësve në aktivitet. Regjistrimi i krediteve bëhet nga QKEV-ja në dosjet individuale elektronike të të gjithë pjesëmarrësve. Në rastet kur profesionisti ka marrë pjesë si lektor në një aktivitet të edukimit me kohëzgjatje më pak se një javë, atëherë kreditet, që regjistrohen, përllogariten në bazë të kohëzgjatjes së aktivitetit dhe kriterit 1 orë, 2 kredite. Në rastet kur profesionisti ka marrë pjesë si lektor në aktivitet me kohëzgjatje më shumë se një javë, atëherë kreditet, që regjistrohen, përllogariten në bazë të kohëzgjatjes së leksioneve të kryera nga lektori dhe kriterit 1 orë x 2 kredite.

3.2 Regjistrimi i krediteve nga aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht nga institucione të tjera, përveç QKEV-së, bëhen pas kërkesës së profesionistit për njohjen dhe regjistrimin e këtyre krediteve në QKEV. Dokumentet që duhet të paraqiten janë: programi i aktivitetit dhe certifikata e ndjekjes ose diploma e përfutur prej tij me numrin përkatës të krediteve.

4. Aktivitete të edukimit në vazhdim të paakredituara paraprakisht

4.1 Regjistrimi i krediteve nga botimet në revista shkencore, botim i teksteve mësimore, recensimi i botimeve, udhëheqje e oponenta shkencore, ndjekje e praktikave profesionale, stafet profesionale, shkencore në shërbimet klinike të QSUT-së, si dhe postera e abstrakte. Në këtë rast, kërkesa për njohjen dhe regjistrimin e krediteve duhet bërë individualisht nga profesionisti, pranë QKEV-së. Dokumentet që duhet të paraqiten në rastet e botimit të artikujve, kapitujve të librave ose librave, janë fotokopje të kapakut të revistës ose të librit, si dhe fotokopja e faqes së parë të artikullit ose të kapitullit. Në rastet kur profesionisti ka hartuar kurrikula universitare ose pasuniversitare, dokumentet që duhet të paraqiten janë një vërtetim nga fakulteti përkatës dhe një fotokopje e faqes së parë të tyre. Përllogaritja e krediteve për aktivitetet e kësaj kategorie bëhet sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4.2 Regjistrimi i krediteve nga aktivitete të vetëraportuara kryhet në mënyrë individuale nga profesionisti pranë QKEV-së. Profesionisti duhet të deklarojë programet e multimedias, të studimit të literaturës profesionale ose vizitat studimore që ka kryer gjatë një viti kalendarik në funksion të përmbushjes së

nevojave të tij profesionale, si dhe orët aktive të përfshirjes së tij në këto aktivitete. Përlllogaritja e krediteve për aktivitete të kësaj kategorie bëhet sipas aneksit 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Programe universitare të akredituara

Këto programe përfshijnë kurset pasuniversitare me afat të shkurtër, programet e nivelit master dhe programet e doktoraturës (brenda ose jashtë vendit). Konvertimi i krediteve universitare në kredite të edukimit në vazhdim bëhet në bazë të kriterit 1 (një) kredit universitar – 25 (njëzet e pesë) kredite të edukimit në vazhdim.

6. Afatet kohore të regjistrimit të krediteve

6.1 Për regjistrimin e krediteve të përfituara nga aktivitete të përmendura në nënndarjen 3.1, të pikës 3, të këtij kreu, profesionisti duhet të aplikojë për njohjen dhe për regjistrimin e krediteve pranë QKEV-së para datës 31 dhjetor të vitit kalendarik.

6.2 Për regjistrimin e krediteve të përfituara nga aktivitete të përmendura në nënndarjen 4.1, të pikës 4, të këtij kreu, profesionisti duhet të plotësojë formularin përkatës, nëse është i nevojshëm, vetëm një herë për secilin vit kalendarik të ciklit, përpara datës 15 dhjetor.

6.3 QKEV-ja duhet të kryejë procedurat e njohjes dhe regjistrimit të krediteve në dosjen individuale të profesionistit brenda një afati kohor jo më të gjatë se 60 ditë nga data e dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm nga ana e ofruesit ose profesionistit.

6.4 I gjithë dokumentacioni i programit të certifikimit duhet të ruhet nga QKEV-ja sipas legjislacionit në fuqi për arkivat dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

IV. CERTIFIKIMI I PROFESIONISTËVE

1. Njoftimi mbi statusin e certifikimit

Në fund të secilit cikël 4-vjeçar të programit të certifikimit, QKEV-ja njofton në faqen zyrtare profesionistët për përmbushjen e kërkesave të programit të certifikimit dhe njofton institucionet shëndetësore për statusin e certifikimit të profesionistëve të punësuar në to.

2. Përgjegjësitë e institucioneve shëndetësore

2.1 Të gjitha institucionet publike ose private, akademike ose joakademike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, të huaja dhe të vendit, që kanë punësuar profesionistë, të cilët ushtrojnë profesionin e tyre sipas ligjeve në fuqi, kanë përgjegjësi:

2.1.1 Të krijojnë kushte dhe mundësi që profesionistët të përfshihen në aktivitete të edukimit në vazhdim në përputhje me nevojat e pozicionit të tyre të punës;

2.1.2 Të nxitin përfshirjen e profesionistëve në aktivitetet e edukimit në vazhdim dhe të përfshijnë në kontratat individuale të punësimit kërkesat e programit të certifikimit për profesionistët;

2.1.3 Të hartojnë plane institucionale, njëvjeçare ose shumëvjeçare, të zhvillimit profesional të punonjësve të tyre, në përputhje me nevojat individuale, por edhe institucionale. Institucionet janë përgjegjëse që të ofrojnë aktivitete të edukimit në vazhdim për profesionistët e tyre, në mënyrë që ata të mbledhin deri në 30 për qind të numrit total të krediteve të kërkuara përmes këtyre aktiviteteve.

3. Ankimi

Profesionisti ka të drejtë të ankohet pranë QKEV-së për parregullsi në njohjen dhe në regjistrimin e krediteve brenda 30 ditëve nga data e publikimit të rezultateve.

Në rastet kur pretendimet e profesionistit për parregullsinë njohjen dhe regjistrimin e krediteve nga QKEV-ja nuk zgjidhen nga kjo e fundit, atëherë profesionisti ka të drejtë të ankohet pranë Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm brenda 30 ditëve nga data e njoftimit nga QKEV-ja që ankesa e tij nuk është marrë parasysh.

4. Profesionistët e shëndetësisë, të cilët nuk plotësojnë programin e certifikimit sipas përcaktimeve të bëra në këtë projektvendim, i nënshtrohen provimit të certifikimit. Provimi i certifikimit organizohet nga Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe Ministria e Shëndetësisë, sipas modaliteteve të përcaktuara në rregulloren për organizimin e provimit të certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë, e cila miratohet nga Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm.

5. Procesi i certifikimit të ndihmësfarma-cistëve, infermierëve dhe mamive fillon nga data 1 janar 2016.

V. HYRJA NË FUQI

Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKS 1

Lloji i aktivitetit	Nr. i krediteve
Botim artikulli në revistë shkencore	
Revistë shkencore e indeksuar në regjistër ndërkombëtar dhe me faktor impakti	10 ¹ –20 ²
Revistë shkencore e indeksuar në regjistër ndërkombëtar pa faktor impakti	7–15
Revistë shkencore e paindeksuar në regjistër ndërkombëtar dhe pa faktor impakti	5–10
Botim i teksteve mësimore	
Tekst pasuniversitar	25 ³ / 50 ⁴
Monografi	50
Tekst mësimor për studentë të UMT	15–30
Recensimi i botimeve (vërtetuar nga Rektori)	
Recensimi i tekstit	15
Recensimi i artikullit	5
Udhëheqje dhe oponenca shkencore (vërtetuar nga Rektori)	
Udhëheqje teme masteri shkencor	10
Udhëheqje teme doktorature	5
Oponencë teme doktorature	10
Ndjekje e praktikave profesionale (vërtetuar nga shefi i shërbimit)	
Ndjekje e studentëve nga pedagogu mbikëqyrës	1/10 studentë
Stafet profesionale dhe shkencore në shërbimet klinike të QSUT-së (vërtetuar nga shefi i departamentit)	
Pjesëmarrësi aktiv	10
Pjesëmarrësi pasiv	2
Abstrakt/poster i botuar në librin e përmbledhës të:	
Aktivitet i edukimit në vazhdim jashtë vendit	10–20
Aktivitet i edukimit në vazhdim brenda vendit	5–10

Autori i dytë dhe i fundit¹

Autori i parë²

Autorë të tjerë³

Autori i parë⁴

Limiti. Pavarësisht nga numri i abstrakteve ose posterave të botuara brenda të njëjtit aktivitet, vlerësimi bëhet vetëm për një të tillë.

ANEKS 2

Lloji i aktivitetit	Numri i krediteve
Lexim artikulli në revistë shkencore	0.5
Lexim libri shkencor	3
Vizitë studimore (>1 javë)	deri në 5*
Pjesëmarrje në aktivitete kërkimore	deri në 5*

Pjesëmarrja në një vizitë studimore të strukturuar, brenda ose jashtë vendit (*observer ship, study*)

tour etj.), në një institucion shëndetësor publik ose privat, vlerësohet me 0.5 kredite në ditë.